



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Administratori

Nr. 140 Prot.

Shkodër, më 09.01.2026

### URDHËR

Nr. 7, datë 09.01.2026

#### **"PËR ARKËTIMIN E MENJËHERSHËM TË TARIFES VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026"**

Në mbështetje të ligjit nr.80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, në Vendimin e SA nr.182, datë 28.05.2019 "Për miratimin e Rregullores së Studimeve në Universitetin e Shkodrës" nenë 6, pika 7; në VKM nr.288, datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, me kohë të plotë", (i ndryshuar me VKM nr.723, datë 06.12.2018, si dhe VKM nr.778, datë 26.12.2018), në VKM nr.779, datë 26.12.2018 "Për disa ndryshime në vendimin nr.269, datë 29.03.2017, të KM "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar studimi ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa e shkollimit", në VKM nr.780, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të shkollimit në programet e ciklit të dytë të shkollimit, në IAL publike", në VKM nr.251, datë 27.03.2020 "Për një ndryshim në vendimin nr.269, datë 29.03.2017 të KM "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit" (i ndryshuar), në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.211, datë 15.07.2025 "Për miratimin e tarifës vjetore të shkollimit në programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimit me kohë të plotë dhe të programeve të studimeve profesionale për vitin akademik 2025-2026",

#### Urdhëroj:

1. Arkëtimin e menjëhershëm të tarifave të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë dhe ciklit të dytë të studimeve, në një program të integruar apo në një program profesional, sipas tarifave të përcaktuara në aneksin bashkëngjitur.

Studentët të marrin masat për të përmbushur detyrimin për pagesën e tarifës deri më datë 01.03.2026. Përmbushja e këtij detyrimi ligjor brenda afateve të përcaktuara është kusht për pjesëmarrjen e studentëve në sezonin e riprovimeve të pranverës.

Pas këtij afati studentët që nuk e shlyejnë këtë detyrim nuk do të lejohen të hyjnë në asnjë provim dhe me pas do të pezullohen për aq kohë sa nuk e shlyejnë këtë detyrim.

2. Drejtoria e IT të publikojë menjëherë tarifat e shkollimit në faqen zyrtare të UNISHK- kut, të ndara sipas fakulteteve dhe sipas programeve të studimit.

3. Studenti shkarkon faturën nga faqja zyrtare e UNISHK-ut dhe paraqitet tek Posta Shqiptare për të kryer pagesën sipas shumës së përcaktuar në faturë. Pasi kryhet pagesa pranë Postës Shqiptare, studentët e rregullt të çdo kursi dërgojnë një kopje të saj me e- mail në adresën [financa@unishk.edu.al](mailto:financa@unishk.edu.al) Specialistja e financës përgjegjëse për arkëtimet, pas verifikimit ngarkon faturën në sistemin PITAGORA. Në rastet kur gjen parregullsi në faturë njofton me email studentin për problematikën.

4. Studentët e ciklit të parë të studimeve që ndjekin një program të dytë studimi paguajnë tarifën e studimit sipas tabelës bashkëngjitur të ndarë në 2(dy) këste. Kësti i parë të paguhet deri më datë **01.03.2026** dhe kësti i dytë deri më **01.05.2026**.

5. Studentët e ciklit të parë të studimeve të cilësuar në bazë të rregullores si përsëritës paguajnë tarifën e plotë sipas vitit përkatës.

6. Studentët që ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve, për vitin akademik 2025- 2026, paguajnë tarifën e studimit sipas tabelës bashkëngjitur të ndarë në 2(dy) këste. Kësti i parë të paguhet deri më datë **01.03.2026** dhe kësti i dytë deri më **01.05.2026**.

7. Studentët e ciklit të dytë të studimeve që nuk kanë përfunduar studimet brenda kohëzgjatjes minimale të studimeve, të cilësuar në bazë të rregullores si përsëritës FC, i nënshtrohen vetëm tarifës për pikë kredite të diplomës.

8. Studentët që transferojnë studimet nga një program në tjetrin i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin transferohen dhe ndjekin studimet.

9. Përjashtimet nga tarifa vjetore e shkollimit të kategorive sociale përfituese sipas dispozitave ligjore në fuqi për ciklin e parë të studimeve dhe përgjysmimet e tarifave në masën 50% për ciklin e dytë të studimeve të pasqyrohen në sistem deri më dt.**01.03.2026**.

10. Përfitues të reduktimit në masën 50% të tarifës vjetore të shkollimit, në ciklin e parë të studimeve, në një program të integruar, apo në një program profesional do të jenë ata studentë të cilët në përfundim të vitit të parë e në vijim kanë arritur pikët ECTS te nevojshme për kalimin në vitin pasardhës dhe rezultojnë me notë mesatare të ponderuar mbi 6 (gjashtë).

11. Përfitues të reduktimit në masën 50% të tarifës vjetore të shkollimit, në ciklin e dytë të studimeve, do të jenë ata studentë të cilët në përfundim të vitit të parë rezultojnë me notë mesatare të ponderuar 9 deri në 10. Këta studentë duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitin e mëparshëm të programit të studimit përkatës, brenda përfundimit të vitit akademik paraardhës.

12. Përfitues të reduktimit në masën 50% të tarifës vjetore të shkollimit, në ciklin e dytë të studimeve, do të jenë ata studentë të cilët fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë dhe kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë me notën mesatare 9 deri në 10.

13. Përjashtohen nga tarifa e shkollimit studentët e ciklit të parë të studimeve në vitet pas të parit që rezultojnë me notë mesatare vjetore 9 deri në 10. Këta studentë duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitin e mëparshëm të programit të studimit përkatës, brenda përfundimit të vitit akademik paraardhës.

14. Përrjashtohen nga tarifa e shkollimit studentët e pranuar në vitin e parë akademik me notë mesatare 9 deri në 10 nga arsimit i mesëm i lartë, përfshirë edhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore. Listat e këtyre studentëve hartohen dhe përcillen nga QSHA.

15. Paguajnë të plotë tarifën vjetore të shkollimit, studentët e pranuar në vitin e parë të ciklit të parë të studimeve, me notë mesatare nën 6 (gjashtë) nga arsimit i mesëm i lartë përfshirë edhe provimet e Maturës Shtetërore.

16. Shtetasit e huaj, që ndjekin studimet në një program të parë apo në një program të dytë studimi të ciklit të parë të studimeve apo në një program të ciklit të dytë të studimeve, në një program të integruar apo në një program profesional, i nënshtrohen të njëjtës tarifë vjetore të shkollimit, si shtetasit shqiptarë që ndjekin studimet në këto programe studimi, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare shtetërore, janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave vjetore të shkollimit.

17. Specialistja e financës përgjegjëse për arkëtimin e tarifave të shkollimit të verifikojë me korrektesë realizimin e pagesës së tarifës së shkollimit për studentët e rregullt dhe të pasqyrojë në sistemin PITAGORA brenda 48 orëve nga realizimi i pagesës.

18. Specialistja e financës përgjegjëse për arkëtimet krahason pasqyrat analitike të universitetit me postën e ardhur nga filiali i postës shqiptare dhe bankave, mban evidencë mujore për arkëtimet dhe raporton realizimin pranë Drejtorit ekonomik dhe Administratorit si dhe mban lidhjet me sekretariatë mësimore.

19. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Drejtoria ekonomike, Drejtoria IT, Sekretariatë mësimore.

20. Urdhri i përcillet Njësive kryesore dhe u bëhet i ditur studentëve përmes publikimit në faqen zyrtare të UNISHK.

21. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**Administratori**

**Enejda Vadohéj**



## Aneksi 1


		ECTS	Tarifë e plotë	Tarifë 50% e reduktuar	Program i dytë studimi
<b>Bachelor</b>					
Nr.	<b>Fakulteti i Shkencave Shoqërore</b>				
1	Gjuhë - Letërsi (BA)	180	20.000	10.000	50.000
2	Gazetari dhe Komunikim (BA)	180	20.000	10.000	50.000
3	Histori (BA)	180	20.000	10.000	50.000
4	Histori dhe trashëgimi kulturore (BA)	180	20.000	10.000	50.000
5	Gjeografi (BA)	180	20.000	10.000	50.000
6	Gjeografi dhe Zhvillim Territori (BA)	180	20.000	10.000	50.000
<b>Fakulteti i Shkencave të Edukimit</b>					
1	Mësuesi për Arsimin Fillor (BA)	180	20.000	10.000	50.000
2	Mësuesi për Arsimin Parashkollor (BA)	180	20.000	10.000	50.000
3	Edukim Fizik dhe Sporte (BA)	180	20.000	10.000	50.000
4	Pedagogji muzikore (BA)	180	27.000	13.500	50.000
5	Pikturë dhe grafikë (BA)	180	27.000	13.500	50.000
6	Psikologji (BA)	180	25.000	12.500	50.000
7	Punë sociale (BA)	180	25.000	12.500	50.000
<b>Fakulteti Ekonomik</b>					
1	Financë- Kontabilitet (BA)	180	20.000	10.000	50.000
2	Administrim-Biznes (BA)	180	20.000	10.000	50.000
3	Turizëm (BA)	180	20.000	10.000	50.000
<b>Fakulteti i Gjuhëve të Huaja</b>					
1	Gjuhë angleze (BA)	180	20.000	10.000	50.000
2	Gjuhë Italiane (BA)	180	20.000	10.000	50.000
3	Gjuhë Frënge (BA)	180	20.000	10.000	50.000
4	Gjuhë Gjermane (BA)	180	20.000	10.000	50.000
<b>Fakulteti i Shkencave të Natyrës</b>					
1	Matematikë (BA)	180	20.000	10.000	50.000
2	Informatikë (BA)	180	20.000	10.000	50.000
3	Fizikë (BA)	180	20.000	10.000	50.000
4	Biologji-Kimi (BA)	180	20.000	10.000	50.000
5	Shkencat e Ushqimit (BA)	180	20.000	10.000	50.000
6	Infermieri e Përgjithshme (BA)	180	20.000	10.000	50.000
7	Fizioterapi (BA)	180	20.000	10.000	50.000
8	Infermieri - Mami (BA)	180	20.000	10.000	50.000
<b>Fakulteti i Drejtësisë</b>					
1	Drejtesi (BA)	180	25.000	12.500	25.000

Nr.	Programe me karakter profesional	ECTS	Tarifë e plotë	Tarifë 50% e reduktuar
	<b>Fakulteti i Shkencave Shoqërore</b>			
1	Udhërrëfyes turistik dhe menaxhues i itinerareve turistike për rajonin verior	60	40.000	20.000
	<b>Fakulteti i Shkencave të Natyrës</b>			
1	Teknik sitemesh dhe rrjetesh kompjuterike	120	20.000	10.000
2	Specialist i Lartë Elektrik	120	20.000	10.000

		ECTS	Tarifë e plotë	Tarifë 50% e reduktuar	Program i dytë studimi
<b>Master shkencor</b>					
<b>Fakulteti i Shkencave Shoqërore</b>					
1	MSH Studime Regjionale në Gjeografi	120	50.000	25.000	50.000
2	MSH Mësuesi në Histori - Gjeografi	120	60.000	30.000	60.000
3	MSH Studime të Historisë dhe të Kulturës Shqiptare	120	50.000	25.000	50.000
<b>Fakulteti i Shkencave të Edukimit</b>					
1	MSH Psikologji Klinike	120	60.000	30.000	60.000
2	MSH Psikologji Organizative	120	60.000	30.000	60.000
3	MSH Mësuesi në Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet	120	60.000	30.000	60.000
<b>Fakulteti Ekonomik</b>					
1	Marketing inovativ	120	60.000	30.000	60.000
2	MSH Financë	120	60.000	30.000	60.000
3	MSH Kontabilitet	120	60.000	30.000	60.000
4	MSH Administrim Biznesi	120	60.000	30.000	60.000
5	MSH Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm	120	60.000	30.000	60.000
<b>Fakulteti i Shkencave të Natyrës</b>					
1	MSH Biologji Mjedisore	120	60.000	30.000	60.000
2	MSH Mësuesi në Biologji - Kimi	120	60.000	30.000	60.000
3	MSH Mësuesi në Matematikë - Fizikë	120	60.000	30.000	60.000
4	MSH Mësuesi në Matematikë	120	60.000	30.000	60.000
5	MSH Mësuesi në Informatikë	120	60.000	30.000	60.000
6	Siguria e cilësisë së ushqimit dhe të ushqyerit	120	60.000	30.000	60.000
7	Infermieri klinike	120	60.000	30.000	60.000
<b>Fakulteti i Drejtësisë</b>					
1	MSH E drejta kushtetuese dhe administrative	120	50.000	25.000	50.000
2	MSH E drejta private dhe e biznesit	120	50.000	25.000	50.000

		ECTS	Tarifë e plotë	Tarifë 50% e reduktuar	Program i dytë studimi
<b>Master profesional</b>					
<b>Fakulteti i Shkencave Shoqërore</b>					
1	MP Mësuesi në Gjuhë- Letërsi	120	50.000	25.000	50.000
2	Gis dhe Planifikim territori	60	60.000	30.000	72.000
3	MP Mësuesi në Histori-Gjeografi	120	50.000	25.000	50.000
<b>Fakulteti i Shkencave të Edukimit</b>					
1	MP Mësuesi në lëndët edukim fizik e sporte	120	60.000	30.000	72.000
2	MP Mësuesi për Arsimin Fillor	120	60.000	30.000	72.000
3	MP Pedagogji Speciale	120	60.000	30.000	72.000
4	MP Mësues Muzike	120	60.000	30.000	72.000
5	Mësues i Artit Pamor	120	60.000	30.000	72.000
6	MP Shërbimet sociale	60	60.000	30.000	72.000
<b>Fakulteti Ekonomik</b>					
1	MP Financë- bankë	120	60.000	30.000	72.000
2	MP Menaxhimi financiar, kontabiliteti dhe kontrolli në administratën publike	60	60.000	30.000	72.000
3	MP Administrim Biznes	120	60.000	30.000	72.000
4	MP Trashëgimi Kulturore dhe Menaxhimi Turizmi	120	60.000	30.000	72.000
<b>Fakulteti i Gjuhëve të Huaja</b>					
1	MP Mësuesi në Gjuhën Angleze	120	60.000	30.000	72.000
2	MP Mësuesi në Gjuhën Italiane	120	48.000	24.000	72.000
3	MP Mësuesi në Gjuhën Frënge	120	48.000	24.000	72.000
4	MP Mësuesi në Gjuhën Gjermane	120	48.000	24.000	72.000
<b>Fakulteti i Shkencave të Natyrës</b>					
1	MP Psikologji Shëndeti	60	60.000	30.000	72.000
2	MP Mësuesi në Informatikë me profil minor në Matematikë	120	60.000	30.000	72.000
3	MP Mësuesi në Matematikë me profil minor në Informatikë	120	60.000	30.000	72.000
4	MP Mësuesi në Biologji - Kimi	120	60.000	30.000	72.000
5	MP Mësuesi në Matematikë - Fizikë	120	60.000	30.000	72.000
6	MP Zhvillim programesh të avancuara	60	60.000	30.000	72.000

	Fakulteti i Drejtësisë	ECTS	Tarifë e plotë	Tarifë 50% e reduktuar	Program i dytë studimi
1	Program i integruar i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi	300	25.000	12.500	25.000



**Fakulteti i Shkencave të Edukimit**

	ECTS	Tarifë e plotë
1 Programit të formimit të vazhduar në fushën Psiko - Pedagogjike	35	30.000